

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

LËNDA: Gjuha italiane

(klasa e katërt)

VITI SHKOLLOR 2007--2008

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. TË PËRGJITHSHME
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE
- III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- IV. AKTET, FUNKSIONET KOMUNIKUESE
- V. SFERA TEMATIKE DHE LEKSIKU
- VI. ELEMENTE DHE STRUKTURA GRAMATIKORE
- VII. SHPËRNDARJA E ORËVE
- VIII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT
- IX. VLERËSIMI DHE VETËVLËRËSIMI

I. TË PËRGJITHSHME

Është viti i pestë rresht përgjatë të cilëve cikli fillor i arsimit të detyruar (shkolla pilot në rreth 20 rrethe të vendit) është përfshirë në projektin "Iliria" -fryt i bashkëpunimit të dy dikastereve të arsimit të vendeve përkatëse, Shqipërisë dhe Italisë, në qendër të të cilit është mësimdhënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj e detyrueshme, duke filluar që nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë të shkollës 9-vjeçare, me nxënës që përfshihen në grup-moshat 8-15 vjeç.

Në këtë kuadër, ky program për gjuhën italiane përmban elementet e nevojshme në formë udhëzimesh, të cilat duhet të mbahen parasysh gjatë veprimtarisë së mësimdhënies; ato të angazhojnë subjektet e ndryshme bashkëpjesëmarrëse (mësues, drejtorë shkollash, inspektorë, autorë tekstesh dhe specialistë) për të vepruar me vetëdijen se bëhet fjalë për një sfidë komplekse për të garantuar një realizim të suksesshëm dhe në funksion të objektivave të paracaktuar. Prandaj është e rëndësishme mobilizimi i menjëhershëm i të gjitha forcave për të bërë të mundshme një bashkërendim të synimeve ndërmjet aktorëve pjesëmarrës në procesin mësimor, duke vënë në dukje përvojat më pozitive të përftuara gjatë këtyre viteve të para (2002-2006), duke përgjithësuar dhe duke përmirësuar aftësitë profesionale tashmë të afirmuara të mësuesve, si edhe të materialeve dhe pajisjeve didaktike në përdorim; pjesëmarrja e ndërgjegjshme, si edhe bashkëpunimi efektiv në të gjitha nivelet do të përbëjnë një element vendimtar dhe do të lehtësojnë suksesin e plotë të projektit.

Mësimdhënies së gjuhës italiane në klasën IV i është caktuar një sasi prej 68 orësh mësimore, të shtrira përgjatë gjithë vitit, përkatësisht me 2 orë mësimi në javë.

Synimet dhe objektivat didaktikë të këtij programi janë hartuar mbi bazën e atyre të programuara për klasën pararendëse (klasa III) dhe së bashku me klasën pasardhëse (klasën V) ato përbëjnë ciklin fillor (klasat I-V) në hallkat e arsimit të detyrueshëm shqiptar.

Ky program, i konceptuar mbi bazë funksionale, e ka përqendruar drejtimin e vet kryesisht mbi funksionin emotiv apo vetjak, si edhe mbi atë social, të cilat synojnë të integrohen me mjedisin përreth fëmijëve përgjatë pjesës më të madhe të ditës.

Qoftë nocionet e përgjithshme, qoftë ato të veçanta mbi të cilat është konceptuar e tërë kurrikula, dhe për rrjedhojë i tërë kursi gjuhësor, kanë mbajtur parasysh moshën e nxënësve me karakteristikat moshore përkatëse. Për këtë arsye janë lënë mënjanë tema dhe nocione që ata nuk i njohin ende, edhe pse shpesh janë të ekspozuar ndaj burimesh të ndryshme mediatike.

Struktura dhe përmbajtja e këtij programi pasqyron gjerësisht atë çka këshillon vizioni kurrikular (ISP, 2004), kurrikula kombëtare e gjuhëve moderne (MASH, 1999), si dhe kuadri i përbashkët i referencave të këshillit të Evropës (Strasburg, 1998).

II. SYNIMET EDUKATIVE DHE DIDAKTIKE

Mësimdhënia e gjuhës së huaj, parashikuar në programet e shkollës sonë fillore, së fundi në fazë eksperimentale edhe përe gjuhën italiane, përbën një kthesë me vlerë pedagogjike dhe kulturore në kuadrin e reformave në sistemin arsimor.

Mësimdhënia e gjuhës së huaj rrit mundësitë që shkolla fillore u ofron nxënësve për zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe të ndërgjegjësimit të tyre ndërkulturor. Kjo është përgjigja e duhur ndaj politikave nxitëse të formimit të qytetarit evropian.

Mësimdhënia/nxënia e gjuhës italiane në shkollën fillore ndihmon në formimin e përgjithshëm të nxënësit; zgjeron aftësitë e tij shprehëse; ofron modele të të sjellurit në situata të caktuara mësimore; ndihmon përfshirjen e nxënësit në shkëmbime të shumëllojshme.

Mësimi i gjuhës italiane, si gjuhë e huaj, njëkohësisht është dhe proces njohjeje i kulturës së popullit Italian. Si i tillë bëhet i mundshëm një zgjerim i horizontit kulturor dhe njohës të nxënësit, duke ndihmuar kështu drejtpërdrejt në formimin e personalitetit të tij.

Mësimnxënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj bart me vete një ndërgjegjësim gjithnjë në rritje për sistemin gjuhësor dhe për funksionimin e gjuhës. Ky është një proces i vazhdueshëm, i cili ecën përpara, duke u përmirësuar vazhdimisht përgjatë jetës.

I tërë procesi i mësidhënies/nxënies së gjuhës italiane në shkollën fillore është i konceptuar si një veprimtari-lojë, si veprimtari argëtuese, si veprimtari motore dhe psikomotore, edhe si veprimtari krijuese me kah komunikimin, shprehjen, punën me tingujt, fjalët dhe frazat. Nxënësi i kësaj moshe rritet përmes veprimit dhe lidhjeve të vazhdueshëm me mjedisin fizik rrethues, duke prekur, duke perceptuar, duke ndërjerë fizikisht.

Megjithatë, të mbahet parasysh karakteri i veçantë i gjuhës italiane si gjuhë komunikimi, duke qenë se ofron raste më të shpeshta përdorimi efektiv, d.m.th. raste rimarrjeje dhe përforcuese të vlefshme për vetë faktin se haset gjerësisht në mjetet e komunikimit masiv, në shkëmbimet ekonomiko-tregtare etj.

Mësimdhënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në shkollën fillore synon zhvillimin e proceseve kognitive, trajnimin e mendjes, krijimin e aftësive njohëse dhe krijuese; mbi të gjitha, ajo synon t'u mësojë nxënësve të ashtuquajturin *way of learning*, d.m.th. të mësojnë si mësohet.

Objektivi kryesor është arritja nga ana e nxënësit në përfundim të kursit të aftësisë kuptimore dhe shprehëse kryesisht gojore, aftësi e cila do t'i lejojë atij të kryejë në gjuhën italiane funksionet komunikuese bazë, të cilat i has në situatat më të shpeshta të jetës së tij. Situata të tilla u përkasin interesave dhe përvojës që karakterizojnë moshën e nxënësit.

III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE

Duke iu referuar kuadrit të përgjithshëm të kurrikulës kombëtare të gjuhëve moderne, niveli i përgatitjes së përgjithshme të nxënësit të klasës së katërt fillore do të përshkruhet sipas standardeve të mëposhtme, të përshkruara sipas 4 aftësive të veçanta:

3.1. Dëgjimi

Nxënësit janë në gjendje të:

- kuptojnë një ligjërim të shkurtër e të thjeshtë gojor, nëse ai është i artikuluar me kujdes dhe përmban pauza që bëjnë të mundshme nxjerrjen e kuptimit;
- kuptojnë fraza dhe shprehje që lidhen me fushat më parësore (p.sh., informacione të thjeshta rreth familjes, tregut, gjeografisë së vendit, shkollës etj.);
- kuptojnë aq sa të përballojnë nevojat imediate me karakter konkret, nëse ligjërimi është i artikuluar ngadalë dhe qartë;
- kuptojnë dhe ndjekin udhëzime të shqiptuara ngadalë;
- kuptojnë udhëzime të thjeshta që kanë të bëjnë me mënyrën për të shkuar nga një vend në një tjetër;

Nxënësit janë në gjendje të njohin llojin e intonacionit (pyetës, tregues dhe urdhërues), si edhe karakteristikat dalluese në shërbim të një komunikimi minimal.

3.2. Të folurit

Nxënësit janë në gjendje të:

- ndërveprojnë në mënyrë të thjeshtë në komunikime të përditshme, nëse frazat përsëriten ngadalë, riformulohen apo dhe qortohen;
- bëjnë pyetje të thjeshta dhe përgjigjen, marrin nisiativën në të folur dhe u përgjigjen pohimeve të thjeshta që lidhen me nevoja imediate apo me çështje shumë të njohura për ta;
- komunikojnë në veprimtari të thjeshta dhe rutinë, të cilat kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë informacioni rreth çështjesh të njohura apo rutinë që lidhen me familjen, shkollën, lojën dhe kohën e lirë;
- pyesin të tjerët si janë dhe reagojnë në mënyrën e duhur ndaj informacioneve që u jepen;
- paraqesin veten dhe të tjerët dhe përdorin shprehje të thjeshta përshëndetëse tipike për takimet a ndarjet;
- shprehin pëlqim apo mospëlqim ndaj diçkaje;
- kërkojnë e japin diçka;
- pyesin për të marrë dhe për të dhënë gjëra njëri-tjetrit;
- porositin diçka për të ngrënë apo për të pirë;
- bëjnë psonisje gjërash të thjeshta, duke treguar çka duan dhe duke pyetur për çmimin;
- japin dhe marrin informacione rreth sasisë, numrave, çmimeve;
- bëjnë pyetje dhe përgjigjen thjeshtë për çështje që kanë të bëjnë me veten e tyre apo me të tjerët (ku jetojnë, njerëzit që njohin, gjërat që zotërojnë);
- pyesin dhe u përgjigjen pyetjeve të thjeshta, nisin apo u përgjigjen pohimeve të thjeshta për çështje të njohura apo që u shërbejnë për të përmbushur nevoja imediate;
- u përgjigjen në një bashkëbisedim pyetjeve të thjeshta dhe të drejtpërdrejta lidhur me çështje vetjake, të shprehura ngadalë dhe qartë, me një gjuhë të thjeshtë e jo idiomatike;
- u përgjigjen pyetjeve të thjeshta dhe reagojnë ndaj pohimesh të thjeshta në një dialog.

3.3. Leximi

Nxënësit janë në gjendje të:

- lexojnë e të kuptojnë fjalë, fraza dhe tekste të shkurtëra, dialogje të thjeshta, të studiuara apo të njohura më parë;
- kuptojnë tekste shumë të shkurtëra, shumë të thjeshta, që përmbajnë një leksik shumë të përdorshëm, duke dalluar emra, fjalë e fraza bazë, edhe duke i rilexuar, nëse është e nevojshme;
- kuptojnë tekste shumë të thjeshta dhe të shkurtëra që trajtojnë çështje të llojit konkret me një gjuhë të përditshme e me përdorim të gjerë që lidhen me situatën shkollore apo me situata të tjera të njohura për nxënësit;
- kuptojnë tekste të thjeshta dialogjike, të shoqëruara me figura apo vizatime;
- kuptojnë mesazhe të shkurtëra, të thjeshta, të shkruara në kartolina apo mesazhe sms në celular apo në postë elektronike;

- dallojnë emra, fjalë dhe fraza të njohura në tekste që lidhen me situatat e përditshme e të zakonshme;
- gjejnë informacion në materiale me përdorim të përditshëm shkollor, si: lajmërime, detyra, orari, etj;
- kuptojnë udhëzime të thjeshta për lojërat apo për garat e ndryshme të moshës;
- kuptojnë tregime dhe përshkrime shumë të shkurtëra e të thjeshta (si: përralla, fabula etj. me leksik të njohur), në të cilat është përdorur e tashmja, e kaluara dhe e ardhmja.

3.4. Shkrimi

Nxënësit janë në gjendje të:

- shkruajnë kartolina të thjeshta;
- shkruajnë numra, data, emrin e tyre, kombësinë, adresën, moshën, datëlindjen, në formularë apo në skeda me të dhëna vetjake;
- shkruajnë fraza të veçuara;
- shkruajnë informacione të thjeshta vetjake.

IV. AKTET OSE FUNKSIONET E KOMUNIKIMIT

Duke patur parasysh nevojat komunikuese të nxënësve, si edhe synimet mësimore e edukative të sistemit tonë arsimor, janë përcaktuar për ciklin fillor të shkollës 9-vjeçare (klasat III-V) një sërë aktesh apo funksionesh komunikuese, të cilat, për nga pesha dhe për nga shkalla e përdorimit, janë ndër më të rëndësishmet. Atyre u përgjigjet një strukturë gramatikore dhe një fushë e caktuar semantiko-leksikore.

Këtu më poshtë është dhënë disa drejtime, pothuaj të plota në të cilan janë përcaktuar nocionet, aktet e komunikimit, strukturat gramatikore dhe leksikore përkatëse:

1. Të takojnë dikë e të njihen me të:
 - 1.1. Të paraqiten e t'i përgjigjen një paraqitjes.
 - 1.2. Të paraqesin persona të tjerë.
 - 1.3. Të kërkojnë e të përgjigjen për emrin dhe mbiemrin.
 - 1.4. Të kërkojnë e të thonë prej nga vijnë.
 - 1.5. Të kërkojnë e të përgjigjen si shkruhet një fjalë.
 - 1.6. Të kërkojnë e të përgjigjen për kombësinë.
 - 1.7. Të kërkojnë e të përgjigjen për moshën
 - 1.8. Të kërkojnë e të përgjigjen për numrin e telefonit.
 - 1.9. Të kërkojnë e të përgjigjen për adresën e banimit apo të një vendi tjetër.
 - 1.10. Të kërkojnë e të përgjigjen për profesione.
2. Të marrin pjesë në një bisedë me karakter të përgjithshëm:
 - 2.1. Të përshëndetin e t'u përgjigjen përshëndetjeve.
 - 2.2. Të kërkojnë e të përgjigjen për orën.
 - 2.3. Të falenderojnë e t'u përgjigjen falenderimeve.
 - 2.4. Të kërkojnë e të japin informacione për shëndetin.
 - 2.5. Të tregojnë objekte dhe persona.
 - 2.6. Të kërkojnë dhe të ofrojnë objekte, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato.
 - 2.7. Të kërkojnë e të japin informacione shumë të thjeshta rreth personash, objektesh dhe vendesh.
 - 2.8. Të bëjnë ftesa, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato.

- 2.9. Të kërkojnë e të përgjigjen për çka dinë të bëjnë (gjuhët, sportet, instrumentet muzikore).
- 2.10. Të kërkojnë leje, ta pranojnë apo ta refuzojnë atë.
- 2.11. Të bëjnë propozime, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato.
- 2.12. Të shprehin habi, admirim përmes pasthirmash.
- 2.13. Të shprehin kënaqësi apo moskënaqësi.
- 2.14. Të kërkojnë e të japin informacione për kohën.
- 2.15. Të shprehin qëllime apo synime.
- 2.16. Të shprehin ndjenjën e frikës, të druajtjes apo të shpresës.
- 2.17. Të kërkojnë e të thonë datën.
- 2.18. Të tregojnë fakte të thjeshta në të tashmen.
- 2.19. Të kërkojnë e të shprehin opinione të thjeshta rreth personash, objektesh, vendesh apo ngjarjesh.
- 2.20. Të bëjnë krahasime.
- 2.21. Të shprehin pëlqim apo mospëlqim.
- 2.22. Të bëjnë deduksione të thjeshta.
- 2.23. Të shprehin nevoja apo dëshira.

3. Të marrin pjesë aktive në një veprim në mjedis publik:

- 3.1. Të tërheqin vëmendjen e dikujt.
- 3.2. Të kërkojnë e të thonë vendndodhjen e objekteve të ndryshme.
- 3.3. Të kërkojnë e të japin udhëzime për rrugën apo adresën.
- 3.4. Të kërkojnë për një mall apo send në dyqan a gjetkë.
- 3.5. Të pyesin për çmimin dhe vlerën.
- 3.6. Të porositin.

4. Të dinë të përdorin mjetet e komunikimit:

- 4.1. Të hapin e të mbyllin një bisedë telefonike.
- 4.2. Të shkruajnë mesazhe të shkurtëra, si edhe letra të thjeshta me karakter informal.

5. Të njohin e të përdorin mjetet e transportit:

- 5.1. Të njohin e të përshkruajnë funksionin e mjeteve më të rëndësishme të transportit.
- 5.2. Të njohin e të përshkruajnë funksionet më të rëndësishme të sinjalitikës rrugore.

V. SFERA TEMATIKE DHE LEKSIKU

Janë përzgjedhur këto sfera tematike apo nocione, të cilat përfaqësojnë interesat dhe nevojat komunikuese të nxënësve të kësaj grup-moshe (8-10 vjeç):

1. Jeta e përditshme:

- familja, të afërmit;
- shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave
- ngjyrat;
- pjesët e trupit;
- lodrat e ndryshme;

- veshja;
- ushqime dhe pije;
- datëlindja;
- ditët, muajt, datat;
- orët, ora.
- 2. Shkolla:
 - shkolla, objektet përreth saj;
 - klasa, objektet dhe sendet në të;
 - shokët dhe shoqet e grupit;
 - personeli i shkollës;
 - orari i mësimëve;
 - lëndët mësimore;
 - veprime aritmetike;
 - librat dhe biblioteka.
- 3. Bota përreth:
 - koha, ndarja e kohës;
 - zyrat publike;
 - tregu, dyqanet, monedhat;
 - spitali, shëndeti;
 - rruga, mjetet e transportit, qarkullimi rrugor, vendndodhjet;
 - kafshët.
- 4. Numrat:
 - numërorët themelorë dhe rreshtorë;
 - veprime me numrat.
- 5. Tregime, përralla, fabula, gjëegjëza të moshës.

VI. ELEMENTE DHE STRUKTURA GRAMATIKORE

Ndër strukturat më të përdorshme që bëjnë të mundshme realizimin e komunikimit në nivel minimal në fushat që lidhen me nxënësit e kësaj grup-moshe, janë:

- 1) Gjinia dhe numri i emrave të rregullt;
- 2) Mbiemrat cilësorë dhe shkallët e krahasimit të tyre;
- 3) Zgjedhimi vepror i foljeve ndihmëse *essere* dhe *avere*, si edhe i foljeve të rregullta në mënyrat dhe kohët e mëposhtme:
 - presente indicativo
 - passato prossimo
 - urdhërore (forma veprorë dhe mohuese në vetën 2-të njëjës dhe shumës);
- 4) Foljet modale;
- 5) Përemrat:
 - përemra vetorë kryefjalorë, kundrinorë;
- 6) Ndajfoljet kryesore:
 - të kohës, si: *prima, poi, dopo, già, ora/adesso, sempre, mai, oggi, domani, ieri*;
 - të vendit, si: *qui/qua, lí/lá, sopra, sotto, giú, dentro, fuori, vicino, lontano, davanti, dietro, a destra, a sinistra*;
 - të tjera mjaft të përdorshme, si: *cosí, molto, poco, assai, tanto, piú, meno, meglio, bene, male*;

-ci (+essere).

- 7) Numërorët themelorë nga 1 në 20, numërorët rreshtorë nga I në X.
- 8) Parafjalë të thjeshta dhe të përbëra;
- 9) Fraza të thjeshta: fjali dëftore, pyetëse (të parapririra nga *chi, come, dove, quando, perchè, che cosa*), urdhërore;
- 10) Fraza të përbëra:
 - fjali të bashkërenditura me *ma* dhe *e*;
 - fjali të nënrenditura, kryesisht kohore dhe shkakore.

VII. SHPËRNDARJA E ORËVE

35 javë x 2 orë = 70 orë

Aspekti komunikues-kulturor:	32 orë
Aspekti gjuhësor:	28 orë
Të lira:	10 orë
Gjithsej:	70 orë

Aspekti komunikues-kulturor (32 orë). Pa rënë ndesh me parimin e autonomisë së mësuesit në mësimdhënie, përgjithësisht këshillohet që afër 32 orë mësimore t'u kushtohen veprimtarive me karakter komunikimi, përfshirë këtu të ushtruarit, në situata komunikuese, të njohurive, strukturave, nocioneve që ngërthejnë materialet e ndryshme didaktike, si: teksti, materiale integruese etj., rimarrjen dhe përsëritjen e njohurive të fituara deri në atë pikë, rimarrjen dhe përforcimin deri në ngulitje të funksioneve, nocioneve e strukturave komunikuese më të rëndësishme.

Aspekti gjuhësor (28 orë). Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi ftohet të shtjellojë, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore, ushtrime gjuhësore (gramatikore e leksikore), rimarrje dhe përforcim të atyre të mësuara më parë apo edhe të atyre të reja.

Të lira (10 orë). Në këto orë të lëna në dispozicion të mësuesit, mund të zhvillohen përsëritje, detyra kontrolli, plotësim të orëve kushtuar aspektit qoftë komunikues, qoftë gjuhësor.

VIII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Tematika e programit është konceptuar si një bashkësi skedash, të cilat mësuesi mund t'i përdorë apo t'i organizojë sipas një renditjeje të përshtatshme në shërbim të këndvështrimit të vet dhe në varësi të kushteve të klasës apo nxënësve me të cilët punon.

Një mundësi me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxëniti pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje, duhen përdorur veprimtari në të cilat të ndërfitet sa më shumë të jetë e mundshme nxënësi. P.sh., për të zhvilluar bisedën, do të ishte më mirë që në vend që të përdoreshin figurat apo vizatimet e librit a të materialeve të tjera të përzgjedhura, të bëhej referim konkret tek sendet e pranishme në klasë apo t'u kërkohet vetë nxënësve që të sillnin nga shtëpia disa sende apo objekte që lidhen me temën përkatëse.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve duhen përdorur sa më shumë lojëra, teknika dramatizimi e veprimtari zbatimëse. Loja i krijon mundësi

përfshirjeje fizike dhe emotive të nxënësit në veprimtaritë në grup dhe i krijon mundësi atij të dalë jashtë mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi i krijon mundësi pjesëmarrje përmes dialogjeve në shkëmbime me karakter komunikues, të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar. Qoftë loja, qoftë dramatizimi bëjnë të mundshme përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: fjalën, veprimin, gjestin.

Në fazën e paraqitjes së materialit gjuhësor lipset që, përmes shoqërimit me një objekt konkret, me një figurë, me një tingull, një gjest apo një veprim, të bëhet i mundshëm kuptimi i domethënies së një fjale apo të një shprehjeje.

Për shpjegimet e ndryshme, për të paraqitur një lojë apo një veprimtari praktike, mësuesi të përpiqet të jetë sa më i qartë e i kuptueshëm. Për këtë arsye, ai duhet të jetë i sigurtë që nxënësit e tij janë në gjendje ta kuptojnë e ta ndjekin kur flet në italishte. Kur vëren se moskuptimi shkakton edhe një moskryerje normale të veprimtarisë që paraqet, atëherë mësuesi nuk duhet të hezitojë të përdorë gjuhën amtare, duke përdorur shprehje, si: “Ta zemë se...”, “Të mendojmë se...” etj.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo të lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, nga roli fillimisht i aktorit duhet të kalojë në rolin e regjizorit që drejton aktorët (nxënësit), duke i nxitur ata e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë të jetë e qartë në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik. Të nxënët e shqiptimit dhe të intonacionit të saktë lehtësohet nga përdorimi i rregullt i gjuhës italiane, i poezive apo të këngëve në klasë, si edhe përmes ndjekjes së programeve televizive jashtë saj.

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundur që të gjithë nxënësit të përfitojnë duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset puna me grupe (skuedra) apo çifte, në brendësi të cilave të mos lejohet monopolizimi vetëm nga ana e 1-2 nxënësve më të mirë, por t’u jepet mundësia të gjithëve të marrin pjesë. Mësuesi i nxit të gjithë që të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor duhet të jetë:

-Induktiv dhe konkret. Është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore.

-I paraqitur në formë loje apo problemi për zgjidhje, i tillë që të nxitë nxënësit të vënë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;

-I bazuar jo mbi një metodologji të përqendruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit, natyrisht i ndihmuar edhe nga mësuesi.

Veprimtaritë e paraqitura në libër duhet të vlerësohen më shumë si një material referues dhe input për një veprimtari më të thelluar nga secili mësues në mënyrë autonome, duke përpunuar materiale, teknika apo tekste e modele sipas shembullit të vetë librit apo edhe thjesht, duke iu referuar programit.

Vëzhgimet sistematike të kryera nga ana e mësuesve gjatë procesit mësimor përbëjnë një mjet të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes, duke u dhënë mundësinë që të përfshijnë në kohën dhe vendin e duhur ato përmirësime apo plotësime që i gjykojnë të nevojshme. Kur niveli i nxënësve të klasës së katërt, për arsye e shkaqe të ndryshme, del më i lartë se ai i përcaktuar në standardet ku mbështetet ky program, atëherë, për të mos shkaktuar demotivim, si edhe për të shmangur monotoninë,

mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme:

- Të garantojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;
- Të garantojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën gjatë dialogut;
- Të kufizojë strukturat dhe leksikun e ri të paraqitur;
- Të mbajë parasysh që gjatësia e tekstit të ofruar të jetë e mjaftueshme për kontekstualizimin e formave të reja që të bëhet kështu i mundur një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;
- Të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;
- Të përdorë mjete vizive ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista etj., kur i mungojnë aparaturat tv), të cilat e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur.

Në marrëdhëniet e mësuesit me grupin, thelbësore për ecurinë dhe suksesin e procesit është vendosja e një klime të qetë bashkëpunimi nxënës-nxënës dhe nxënës-mësues. Kjo klimë besimi dhe respekti reciprok vendoset përmes komunikimit të vazhdueshëm për të njohur interesat, problemet, nevojat dhe vështirësitë. Mësuesi duhet të mos kritikojë mospjekjet e nxënësve të vet, gabimet t'i vlerësojë si një fazë e pashmangshme dhe kalimtare të procesit të nxënies, duke ndërhyrë vetëm në momente të përshtatshme e duke bërë përgjithësime kur është e mundur, por pa ndërprerë fluksin komunikues. Duhet nxitur përpjekjet e nxënësve për t'u shprehur në gjuhën italiane.

Edhe gjatë vitit të dytë të mësimin të italishtes (klasa IV) qasja didaktike të jetë kryesisht gojore, për të shmangur vështirësitë që lidhen me shqiptimin dhe grafinë e fjalëve apo të frazave në italishte. Më pas, kur nxënësit tregojnë se e kanë asimiluar shqiptimin e teksteve gojore të dhëna, kalohet në fazën e leximit, e cila do të synojë kryesisht në paraqitjen në formë të shkruar të teksteve të njohura me gojë. Nga leximi mund të kalohet më tej në veprimtari kopjuese apo rishkruese të fjalëve të veçanta me gjurmë, duke mbushur vendet bosh brenda fjalës apo brenda frazave të njohura më parë.

X. VLERËSIMI DHE VETËVLERËSIMI

XI.

Me synimin për të siguruar një vlerësim efektiv të procesit mësimor, të pikënisjes dhe të pikëmbërritjes, të vështirësive të hasura, si edhe të masave të ndërmarra, mësuesit të mbledhin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme informacion lidhur me zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive, lidhur me gatishmërinë ndaj të nxënës, me shkallën e ndërveprimit për çdo nxënës.

Mbi bazën e qasjes glotodidaktike të përdorur, edhe faza e verifikimit të arritjes së objektivave dhe e vlerësimit të aftësive përqendrohet mbi të kuptuarit dhe të prodhuarit gojor.

Informacionet të mblidhen në mënyrë sintetike, që të bëjnë të mundur një ballafaqim të nivelit të përparimit individual dhe kolektiv, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së marrë në shqyrtim. P.sh., aftësitë me shkrim të vlerësohen përmes veprimtarive të tilla, si: kopjimi i fjalëve apo frazave të shkurtra, plotësimi i vendeve bosh brenda fjalëve apo frazave të shkurtëra, përmes batutave të shpeshta në një dialog të shkurtër, mesazheve të urimit, listave të thjeshta me rroba, ushqime, sende të klasës apo të shtëpisë.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT

Teksti i gjuhës italiane për klasën IV të shkollës 9-vjeçare mbështetet në programin e lëndës të miratuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës.

Në hartimin e tekstit këshillohet të ndiqen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

Zgjedhja dhe seleksionimi i materialit të bëhet në përputhje me një publik dhe mjedis specifik, pra nxënës të grup-moshës 10-11 vjeç. Prandaj teksti t'u përgjigjet kërkesave dhe interesave të kësaj grup-moshe. Nëpërmjet tij nxënësi zbulon, vepron dhe bashkëvepron.

Autorët janë të lirë të vendosin temat atje ku ato mundësojnë përshtatje me qëllimet mësimore, gjuhësore-strukturore, kulturore dhe ndërthurjen e tyre.

Për të realizuar integrimin, është e nevojshme që teksti të jetë i ndarë me njësi didaktike dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore.

Materiali të jetë tërheqës, me personazhe të pëlqyera nga nxënësit e kësaj moshe, me ngjyra dhe figura të shumëllojshme që të mundësojnë nxitjen e nxënësve në nxënien e gjuhës së huaj.

Veprimtaritë të jenë të tilla që të nxisin imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve.

Nëpërmjet mjeteve të mësipërme, të mbahet parasysh futja e elementeve të kulturës dhe të qytetërimit italian në shërbim të njohjes së tyre nga ana e nxënësit.

Këshillohet që aparati pedagogjik i çdo mësimi të shoqërohet me rubrikat përkatëse, të cilat pasyrojnë integrimin aftësive gjuhësoro-komunikuese.

Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si: të lexuarit, të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit, të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti të integruara në çdo orë mësimi. Veprimtaritë në tekst të ndërtohen duke patur parasysh përdorimin e figurave, të këngëve të shoqëruara me veprime, ngjyrosjes, lojës me letra ngjitëse, dialogjeve të thjeshta etj.

Teksti të përmbajë: ushtrime me shkrim nëpërmjet historive, përrallave të shkurtëra, komente të thjeshta për figura, veprimtari që forcojnë bashkëpunimin dhe shmangin konkurrencën, tabela vetëvlerësuese që e lejojnë fëmijën të vetëqortohet.

Teksti të jetë i shoqëruar me libër mësuesi.

Rimarrja dhe përforsimi i njohurive, si një parim didaktik, të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, për lidhjen dhe përforsimin e njohurive të dhëna në mësimet e mëparshme. Këshillohet përfshirja e mësimëve përsëritëse në mënyrë periodike.

Kërkohet që teksti i gjuhës italiane të krijojë mundësi të zhvendoset veprimtaria e mësuesit nga figurë qendrore në mësimdhënie në figurë integruese, plotësues, ndihmëse, duke ia lënë qendrën e procesit të mësimi nxënësit.

Këshillohet që në tekst të ketë baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale dhe kolektive.

Veprimtaritë e përfshira në tekst t'u përshtaten karakteristikave të personalitetit të nxënësve.

Punët me shkrim nuk janë të detyruara si përbërëse e çdo ore mësimore, por të para si veprimtari që i përfshijnë nxënësit në veprimtari të gjera krijuese dhe zbatuese.